

2014-ta "Viti i De Radës"

Pas një kohe të gjatë të mosfunksionimit, që nga viti 2008, në ambientet e Ministrisë së Kulturës u mbledh dje në mbledhjen e parë Këshilli Kombëtar i Librit, në përbërje të të cilit janë: Ministrja Kumbaro Furxhi, me përfaqësuesit e propozuar: Shaban Sinani, Persida Asllani, Brikena Çabej, Eda Derhemi, kryetari i Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, Petrit Ymeri, Arlinda Dudaj, kryetari i Akademisë së Shkencave, Muzafer Korkuti. Mbledhja u zhvillua në mungesë të



dy anëtarëve: Shaban Sinani dhe Persida Asllani. Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Librit dhe Nxitjes së Leximit u organizua për: "Sfidat e librit shqip në realitetin e sotëm artistik, ekonomik, juridik dhe teknologjik; Emancipimi i mëtejshëm i raporteve autor, përkthyes, botues, lexues si tregues i emancipimit të shoqërisë shqiptare; Fuqizimi i raporteve me librin dhe leximin në përgjithësi tek fëmijët dhe të rinjtë, si dhe zgjerimi i audiencave"

U përkrah ideja e shpalljes së "Vitet të De Radës", me bashkëfinancim të Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës dhe Sporteve të Kosovës dhe përgatitjes së veprës nga studiues dhe autorët arbëreshë. Fakulteti i Filologjisë, departamenti i Gjuhës shqipe, përfaqësuar nga Dhurata Shehri, kërkoi që edhe aktivitetet e organizuara nga departamenti të përfshihen në këtë veprimtari, kushtuar personalitetit të letrave shqipe. Anëtarët e Këshillit diskutuan dhe shfaqën interesimin e jashtëzakonshëm nga pjesa shqiptare e Malit të Zi dhe Maqedonisë në botimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në nder të De Radës në këto treva. Njëzëri u shtrua ideja e mbledhjeve të afërta të Këshillit Kombëtar të Librit. Me rëndësi do të jetë edhe shpallja së afërmi e Konkursit Kombëtar për të rinj deri në moshën 18 vjeç me temën "Unë, Milosao". U vendos për anëtarët e Komitetit që do të mbikëqyrë aktivitetet e vitit: Francesco Altimari, Matteo Mandala, Dhurata Shehri, Brikena Çabej dhe Shaban Sinani.

Postoje në:



Seleziona lingua

Powered by

Google
Traduttore

Kujdes. Të gjitha të drejtat e këtij shkrimi janë të rezervuara nga Mapo dhe mapo.al.